



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 158/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.03.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-90314-10-17-2018 me objekt: “Shërbim printimi fatura uji”, me fond limit 19.190.164,50 lek pa tvsh, zhvilluar ne daten 09.01.2019 nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.”

Ankimues:

“Albanian Digital Printig Solutions & Services” sh.p.k
Rr. “Çerçiz Topulli”, Nr.17, Kashar,Tiranë

“Adel Co” sh.p.k
Rr. “M. Gjollësja”, Zogu i Zi,Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a
Rr. Qamil Guranjaku, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.10.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-90314-10-17-2018 me objekt: “*Shërbim printimi fatura uji*”, me fond limit 19.190.164,50 lek pa tvsh, zhvilluar ne daten 09.01.2019 nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 21.01.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|---|---------------------------------|
| 1. “Adel Co” sh.p.k | 17.803.843,02 lekë, kualifikuar |
| 2. “Albanian Digital Printig Solutions & Services” sh.p.k | 18.505.854,90 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 25.01.2019 operatori ekonomik “Albanian Digital Printig Solutions & Services” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e shoqërisë “Adel Co” në procedurën e prokurimit.

Konkretisht pretendohet:

1. [...] Shoqëria “Adel CO” sh.p.k duhet skualifikuar pasi:

Së pari, ka dorëzuar deklarime të rreme për qëllime kualifikimi si edhe mbi të gjitha, duke patur detyrime tatimore pranë Administratës Tatimore në vlerën 1.900.000 lekë, në ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit datë 09.01.2019.

Gjithashtu kjo shoqëri nuk përmbush edhe kriteret e vecanta të kualifikimit si edhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi.[...] Bazuar në dyshime të arsyeshme si edhe në faktin se, referuar Ekstraktit mbi Historikun e Regjistrat Tregtar të shoqërisë “Adel Co” sh.p.k ku konstatohet se kapitali dhe llogaritë bankare të kësaj të fundit kanë qënë të bllokuara nga data 14.11.2018 deri më 11.01.2019, bazuar në Urdhërin nr.1664/8-0551-18 Prot, datë 09.11.2018, lëshuar nga shoqëria përmbartimore “Kodra Bailiff Service” sh.p.k, dyshojmë se kjo shoqëri ka patur detyrime ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në datën 09.01.2019, datë e zhvillimit të procedurës së mësipërme të prokurimit. Bazuar në dyshime të arsyeshme, në datën 09.01.2019 shoqëria “Adel Co” sh.p.k ka patur detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore, tatim mbi fitimin dhe TVSH në vlerën rreth 1.900.000 lekë ndaj administratës tatimore [...].

2. [...] Shoqëria “Adel Co” sh.p.k shfaqet në cilësinë e operatorit ekonomik të vetëm në këtë procedurë prokurimi e për rrjedhojë referuar edhe preventivit të shërbimit, natyra e shërbimit që do të kryhet është përmes procesit të printimit të faturës dhe zarfimit në versionin self mailer. Ndërkohë, në dijeninë tonë, referuar edhe eksperiencës dhe arsyeve të skualifikimit në procedurat e tjera të këtij operatori ekonomik, ky i fundit disponon certifikimet ISO 9001:2008 dhe ISO 27001:2013 për printim digjital dhe futje e letrave në zarfe, ndërkohë që rezulton se nuk është i certifikuar sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001 dhe 27001 për kryerjen e shërbimit selfmailer. Edhe në hipotezën e pretendimeve se ISO është një certifikim i përgjithshëm dhe s’mund të përfshijë cdo objekt specifik sërish nuk qëndron. Po ti drejtohem Ekstraktit të Regjistrat Tregtar të shoqërisë “Adel Co” sh.p.k në QKB, rezulton se kjo e fundit ka si objekt të aktivitetit të saj: Printim i faturave në mënyrë dixhitale, selfmail dhe zarfim faturash. Pra vetë operatori ekonomik, në objektin e veprimtarisë së tij, ka parashikuar se janë dy procese të ndryshme, zarfim faturash (futja e letarve në zarfe) dhe procesi selfmailer. Në rastin konkret, megjithëse e ka në objekt të aktivitetit të tij ofrimin e shërbimit të selfmailer, operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k nuk disponon certifikimin ISO 9001:2008 dhe ISO 27001:2013 të shërbimit për selfmailer, objekt i vetëm i procedurës së prokurimit, por vetëm për zarfim faturash, që është një proces teknologjik i ndryshëm dhe manual dhe mbi të gjitha i diferencuar si objekt veprimtarie edhe në vetë Regjistrin Tregtar të shoqërisë “Adel Co” sh.p.k.

3. Në shtojcën mbi modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit parashikohet se:

3.5. Operatori ekonomik duhet të ketë sistem software (sisteme operative dhe aplikacione) +hardware për perpunimin e të dhënave dhe krijimin e fileve për print. Ky sistem duhet të jetë në ambient të mbyllur dhe të dedikuar (i vertetuar me fotografi të ambientit), vëzhguar me kamera 24H/24. Vërtetuar me fatura blerje ose deklaratë zhdoganimi.

Referuar vendosjes së këtij kriteri dhe termave lidhur me sistemin operativ dhe aplikacionet (pra se çfarë nënkupton autoriteti kontraktor me sa më sipër cituar), sqarojmë si më poshtë vijon:

Me “Sistem Operativ të Kompjuterave” nënkuptojmë programin hardware dhe software në një kompjuter, përmes të cilëve arrihet përpunimi i të dhënave, modifikimi i tyre etj...

Duke iu referuar specifikimeve teknike të cilat Autoriteti Kontraktor i ka ngarkuar në sistemin elektronik të APP-së dhe janë pjesë kryesore, thelbësore e kontratës objekt prokurimi vihet re se: Autoriteti Kontraktor do vendosi në dispozicion të shoqërisë të shpallur fituese në procedurën objekt prokurimi, informacionin në formatin Raw Data (XML) të cilat janë të dhëna të pastrukturuara në formatin e skedarëve, imazheve vizuale të bazës së të dhënave dhe të dhënave të tjera digitale. Sa më sipër këto të dhëna nxirren, analizohen, përpunohen dhe përdoren nga aplikacione softuerike për të nxjerrë konkluzione për të bërë parashikime si dhe për të nxjerrë informacione kuptimplota.

Në kuptim të sa më sipër është e domosdoshme që operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurë duhet të vërtetojnë se disponojnë sisteme softuerike dhe harduere të cilat të bëjnë përpunimin e të dhënave dhe krijimin e fileve për print.

Në lidhje me pikën disponim paisjesh hardware, sqarojmë se Autoriteti Kontraktor nënkupton pjesët fizike të prekshme ose komponentët e një kompjuteri, makineri e cila përfshin softwerin për të ekzekutuar një komandë ose një proces pune siç është edhe printimi i faturave që autoriteti kontraktor kërkon të realizojë.

Vërtetimi i pajisjeve hardware ashtu siç dhe është përcaktuar në kriterin 3.5, duhet të bëhet nëpërmjet faturave të blerjeve ose deklaratës së zhdoganimit.

Referuar paqartësisë në lidhje me pjesën e fotografive të cilat Autoriteti Kontraktor kërkon që operatorët ekonomik pjesmarrës t'ia vendosin në dispozicion për të vërtetuar ambientin ku do të mbahen paisjet që do të bëjnë përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemeve softwer dhe hardware si dhe ky ambient të jetë i survejuar me kamera 24h/24h. Pra, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vendosen në dispozicion fotografi të ambientit ku do kryhet procesi i punës.

Në shtojcën për modifikim është përcaktuar:

Në dokumentat standarde të tenderit, kapaciteti teknik, pika 3.7 përcaktohet se ... Operatori ekonomik duhet të ketë të gjitha masat mbrojtëse për mbrojtjen e fileve nga humbja, vjedhja apo aksesit i paautorizuar. Për këtë duhet të dorëzojë një dokument mbështetës (fatura blerje, fotografi) i cili vërteton disponueshmërinë e mjeteve të mësipërme.

Referuar vendosjes së këtij kriteri sqarojmë se AK ka parasysh transportimin e fileve nga vendi i prodhimit pranë AK me sukses që do të thotë: shmangjen e humbjes, vjedhjes apo aksesit të paautorizuar (hakerimi). Operatorët ekonomik për të vërtetuar se disponojnë masa mbrojtëse për të mbrojtur të dhënat nga hackerimi duhet të disponojnë të paktën një nga programet e mëposhtme:

1.Antivirus

2.Firewall

3.Detektor Lëvizje

4.Enkriptim file

Disponimi nga ana e operatorit ekonomik i të paktën një prej programeve të mësipërme duhet të vërtetohet me fatura blerje, nr.serial përkatës.”

[...] Bazuar në dyshime të arsyeshme edhe për shkak të njohurive mbi tregun përkatës, kemi dyshime se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k nuk disponon sisteme software operative në funksion të qëllimeve dhe funksionit të kërkesës së autoritetit kontraktor. Referuar vetë shtojcës dhe sqarimeve të dhëna nga autoriteti kontraktor rezulton se është kërkuar ndër të tjera se me ”Sistem Operativ të Kompjuterave”

nënkuptojmë programin hardware dhe software në një kompjuter, përmes të cilëve arrihet përpunimi i të dhënave, modifikimi i tyre etj...

Duke iu referuar specifikimeve teknike të cilat Autoriteti Kontraktor i ka ngarkuar në sistemin elektronik të APP-së dhe janë pjesë kryesore, thelbësore e kontratës objekt prokurimi, vihet re se: Autoriteti Kontraktor do vendosi në dispozicion të shoqërisë të shpallur fituese në procedurën objekt prokurimi, informacionin në formatin Raw Data (XML) të cilat janë të dhëna të pastruara në formatin e skedarëve, imazhe vizuale të bazës së të dhënave dhe të dhëna të tjera digitale. Sa më sipër këto të dhëna nxirren, analizohen, përpunohen dhe përdoren nga aplikacione softuerike për të nxjerrë konkluzione për të bërë parashikime si dhe për të nxjerrë informacione kuptimplota.

Në rastin konkret, duke marrë në konsideratë natyrën e proceseve që duhen kryer, kompleksitetin e objektit të kontratës si dhe vetë kërkesën specifike, nga autoriteti kontraktor është kërkuar qartësisht që sistemi software duhet të jetë specifik dhe të përpunojë sistemin Raw Dat (XML). Në shqyrtimin e dokumentave të procedurës së prokurimit ju nuk duhet të mjaftoheni me faktin se operatori disponon kontratë, faturë për system softi të përgjithshëm, por system softi specifik. Softi i propozuar duhet të jetë specifik, në funksion të qëllimeve të punës së autoritetit kontraktor si edhe gjithashtu duhet të jetë i pajisur me kod serial përkatës të prodhimit të tij, duke identifikuar qartë prodhuesin.

Në lidhje me pajisjet hardware, nënvizojmë se është kërkuar ndër të tjera pajisje për përpunimin e të dhënave (server) dhe gjithashtu shoqëria duhet të vërtetojë se disponon edhe infrastrukturën përkatëse (rack) e cila duhet të jetë e pasqyruar si me akte pronësie ashtu edhe me fotografitë e objektit për mbajtjen e serverit.

Në lidhje me masat mbrojtëse për mbrojtjen nga sulmet kompjuterike nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë se disponon:

- 1.Antivirus
- 2.Firewall
- 3.Detektor Lëvizje
- 4.Enkriptim file

Disponimi nga ana e operatorit ekonomik i të paktën një prej programeve të mësipërme duhet të vërtetohet me fatura blerje, nr.serial përkatës.

Në plotësim të kriterit të mësipërm gjykojmë se nga ana e operatorit ekonomik duhet të provohet me dy kushte: së pari të disponojë një nga 4 format e mësipërme (që këto forma të jenë të lidhura me serverin) dhe së dyti të vërtetohet edhe kodi serial i tyre. Në rastin konkret gjykojmë se në hipotezën e dorëzimit si masë mbrojtëse nga sulmet kompjuterike e antivirusit nga ana e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k, së pari duhet të vërtetohet se antivirusi është për server dhe jo për laptop, PC normal që janë dy pajisje krejt të ndryshme. Së dyti, duhet të jetë pasqyruar edhe kodi serial i produktit me synim që të vërtetohet së pari se disponohet dhe së dyti që është version zyrtar i prodhuesit dhe jo kopje e hackëruar që nuk shfaq asnjë siguri për autoritetin kontraktor. I njëjti verifikim duhet të kryhet edhe nëse ka dorëzuar dëshmi për Firewall, system enkriptimi file ose dedektor lëvizje.

Gjithashtu referuar njohurive dhe bazuar në dyshime të arsyeshme, duke marrë në konsideratë rëndësinë e procedurës së prokurimit objekt ankimi, kemi dyshime se ambienti i propozuar si vend për kryerjen e shërbimit, nuk përmbush kriteret minimale të sigurisë si edhe nuk është i vëzhguar 24 h me system operativ kontrolli, kamera në përputhje me kriteret e vecanta të kualifikimit. Kemi dyshime të arsyeshme

se nga ana e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k janë dorëzuar fotografi (të cilat sigurisht nuk mund të vërtetohen se së pari është ambient i tij në përdorim dhe së dyti nuk përmbushet qëllimi i autoritetit kontraktor për kryerjen e verifikimit se ambienti i propozuar përmbush minimumin e kërkesës për sigurinë, [...] ndaj AK duhet të kryejë verifikimin përkatës si për mjedisin ashtu edhe për pajisjet Hardware dhe Software.

4. [...] Duke qënë një shoqëri lider në treg dhe duke patur njohuri të thelluara mbi konkurentët tanë, duke marrë në konsideratë edhe eksperiencën në procedurat e mëparshme të prokurimit ku kemi qënë konkurent me të njëjtin operator ekonomik, në dijeninë tonë kjo shoqëri nuk disponon makineri printimi dixhitale me ngjyra me kapacitet minimal printimi prej 50.000 faqe në ditë. Në dijeninë tonë shoqëria “Adel Co” sh.p.k disponon marrëveshje partneriteti dhe pjesë të printerave dixhitale, printera të markës RICOH. Bazuar në dyshime të arsyeshme, duke marrë në konsideratë edhe llojin e pajisjeve (printera industrial) printer i vetëm me ngjyra i prodhuesit RICOH është seria e printerave PRO C901 dhe 901/s. Nga verifikimi online i këtyre printerave, rezulton se kapaciteti maksimal (në rast se janë tërësisht të konfiguruar) në ditë është 13.500 fletë ndërkohë që referuar kritereve të vecanta të kualifikimit është 50.000 fletë. Kjo është lehtësisht e verifikueshme edhe në <https://ëëë.ricoh-ap.com/products/cat34/pid763broch.pdf>

Gjithashtu lloj tjetër printer me ngjyra për përdorim industrial është kategoria e printerave RICOH 907EX/1107EX/135EX. Edhe në hipotezën se kjo shoqëri disponon në pronësi printera të modelit të sipërpërmendur, sërish nuk përmbush kapacitetin teknik, pasi nga verifikimi online i këtyre printerave, rezulton se kapaciteti maksimal (në rast se janë të konfiguruar) në ditë është 10.500 fletë, ndërkohë që referuar kritereve të vecanta të kualifikimit është 50.000 fletë. ... Kemi sërish dyshime se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k nuk e disponon kartelën (skedën teknike) të makinerive origjinale nga prodhuesi.

Gjithashtu gjykojmë se në rast se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k një ose disa nga makineritë e mësipërme nuk i disponon në pronësi, është detyrë e autoritetit kontraktor që të shqyrtojë në themel kontratën e qerasë dhe dokumentacionin bashkëngjitur nëse vërtetohet se qiradhënësi është pronar i printerave të deklaruar për dhënien me qira, duke verifikuar serinë në aktin e zhdoganimit të tyre.”

II.5. Nëpërmjet shkresës Nr.K-364/1 Prot., datë 30.01.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën pasi:

“[...] Referuar pretendimit tuaj se shoqëria “Adel Co” sh.p.k ka detyrime tatimore ndaj administratës tatimore në shumën 1.900.000 lekë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim në tërësi dosjen e procedurës së prokurimit ku vërejtë se:

Autoriteti kontraktor i ka kërkuar informacion administratës tatimore me anë të shkresës nr.prot. 888, nëse operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt prokurimi, rezultonin me detyrime tatimore. Më datë 21.01.2019 pranë autoritetit kontraktor është depozituar shkresa me lëndë “Kthim përgjigje” nr.prot 2268/1 datë 21.01.2019 nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore, me anë të së cilës konfirmohet se shoqëritë pjesëmarrëse në procedurën objekt prokurimi nuk rezultojnë me detyrime tatimore.

Së dyti ju pretendoni se kapitali i shoqërisë dhe llogaritë bankare të shoqërisë “Adel Co” sh.p.k kanë qënë të bllokuara nga data 14.11.2018 deri më 11.01.2019, për të cilën ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ekstraktin historik të shoqërisë “Adel Co” sh.p.k, të shkarkuar nga adresa e QKB, vëren se më datë 14.11.2018 për këtë shoqëri është lëshuar sekuestro konservative me urdhërin nr.1664/8-0551-18 Prot, datë 09.11.2018 nga shoqëria përmbarimore “Kodra Bailif Service”.

Referuar ekstraktit historik, ashtu sic ju pohoni edhe në ankesën e paraqitur pranë UKT sh.a më datë 11.01.2019, nga ana e QKB është pasqyruar heqja e sekuestros konservative për operatorin ekonomik “Adel Co” sh.p.k me anë të urdhërit nr. 1664/33 0551-18 Prot, datë 28.12.2018, lëshuar nga shoqëria përmbarimore gjyqësore “Kodra Bailiff Service”. KShA gjykon se vendosja e masës së sekuestros konservative në pasuritë e një shoqërie nuk do të thote se kjo shoqëri është në proces falimentimi. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, procedura e falimentimit të një subjekti vendoset me vendim gjykate të formës së prerë dhe publikohet në të dhënat tregtare të shoqërisë.

Fakti që në Ekstraktin e Regjistrimit për të dhënat tregtare të subjektit përcaktohet se operatori “Adel Co” sh.p.k ka status aktiv, nuk ka një vendim gjykate të formës së prerë, do të thotë që nuk është në proces falimenti, e për rrjedhojë nuk mund të përbëjë arsye për tu skualifikuar nga një procedurë prokurimi.

Pra referuar ekstraktit historik, statusi i shoqërisë “Adel Co” sh.p.k rezulton aktiv (pra jo i pezulluar) si dhe nuk është në proces falimentimi.

KSHA thekson se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k nuk ndodhet në asnjë prej kushteve të parashikuara në nenin 45, pika 2/a të LPP-së dhe për rrjedhojë nuk përbën arsye për tu skualifikuar nga një procedurë prokurimi.

Së dyti ankimuesi ngre pretendime se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k disponon certifikimet ISO 9001:2008 dhe ISO 27001:2013 për printim digjital dhe futje e letrave në zarfe, ndërkohë që rezulton se nuk është i certifikuar sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001 dhe 27001 për kryerjen e shërbimit selfmailer. Pra operatori ekonomik disponon ISO vetëm për zarfim faturash, që është një proces teknologjik i ndryshëm dhe manual nga shërbimi selfmailer.

K.Sh.A gjykon se objekti i veprimtarisë së një shoqërie tregtare, i pasqyruar në certifikatat e cilësisë ... mund të ketë një karakter dhe formulim të përgjithshëm dhe nuk mund të përfshijë të gjitha emërtimet konkrete të objekteve të një procedure prokurimi, sikundër pretendon ankimuesi.

Në këtë kuadër Komisioni gjykon se nuk është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë të përcaktuar në mënyrë eksplicite objektin e prokurimit në certifikatat e tyre të cilësisë, pasi certifikata nuk lëshohet për një objekt në vecanti e cila nuk është e lidhur aspak me natyrën dhe aftësinë zbatuese të saj.

Sqarojmë ankimuesin se certifikatat e menaxhimit të cilësisë janë certifikata që lidhen me fushën e veprimtarisë tregtuese apo prodhuese që mund të ushtrojë një operator ekonomik dhe jo direkt me një lloj shërbimi që mund të kryejë ai në vecanti, pasi veprimtaria tregtare e një operatori ekonomik mund të jetë shumë më e madhe dhe më e gjërë se sa në llojin e shërbimit selfmailer që kërkon autoriteti kontraktor. ... Në asnjë moment AK nuk ka kërkuar që certifikatat e mësipërme të kenë në objekt të njëjtin lloj natyrë shërbimi me procedurën objekt prokurimi që kërkon të realizojë autoriteti kontraktor.

Së treti “[...] Bazuar në dyshime të arsyeshme edhe për shkak të njohurive mbi tregun përkatës, kemi dyshime se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k nuk disponon sisteme software operative në funksion të qëllimeve dhe funksionit të kërkesës së autoritetit kontraktor.

Në rastin konkret, duke marrë në konsideratë natyrën e proceseve që duhen kryer, kompleksitetin e objektit të kontratës si dhe vetë kërkesën specifike, nga autoriteti kontraktor është kërkuar qartësisht që sistemi software duhet të jetë specifik dhe të përpunojë sistemin Raw Dat (XML). Në shqyrtimin e dokumentave të procedurës së prokurimit ju nuk duhet të mjaftoheni me faktin se operatori disponon kontratë, faturë për system softi të përgjithshëm, por sistem softi specifik. Softi i propozuar duhet të jetë specifik, në funksion të qëllimeve të punës së autoritetit kontraktor si edhe gjithashtu duhet të jetë i pajisur me kod serial përkatës të prodhimit të tij, duke identifikuar qartë prodhuesin.

Në lidhje me pajisjet hardware, nënvizojmë se është kërkuar ndër të tjera pajisje për përpunimin e të dhënave (server) dhe gjithashtu shoqëria duhet të vërtetojë se disponon edhe infrastrukturën përkatëse (rack) e cila duhet të jetë e pasqyruar si me akte pronësie ashtu edhe me fotografitë e objektit për mbajtjen e serverit.

Në lidhje me masat mbrojtëse për mbrojtjen nga sulmet kompjuterike nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë se disponon:

- 1.Antivirus
- 2.Firewall
- 3.Detektor Lëvizje
- 4.Enkriptim file

Disponimi nga ana e operatorit ekonomik i të paktën një prej programeve të mësipërme duhet të vërtetohet me fatura blerje, nr.serial përkatës.

Gjykojmë se në hipotezën e dorëzimit si masë mbrojtëse nga sulmet kompjuterike e antivirusit nga ana e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k, së pari duhet të vërtetohet se antivirusi është për server dhe jo për laptop, PC normal që janë dy pajisje krejt të ndryshme. Së dyti, duhet të jetë pasqyruar edhe kodi serial i produktit me synim që të vërtetohet së pari se disponohet dhe së dyti që është version zyrtar i prodhuesit dhe jo kopje e hackëruar që nuk shfaq asnjë siguri për autoritetin kontraktor. I njëjti verifikim duhet të kryhet edhe nëse ka dorëzuar dëshmi për Firewall, system enkriptimi file ose dedektor.”

Lidhur me këtë pretendim K.SH.A, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k në sistemin elektronik të prokurimeve referuar pretendimeve tuaja, konstaton se: Operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k përmbush kriteret në përputhje me kushtet e kërkuara në DST dhe për rrjedhojë pretendimet tuaja nuk qëndrojnë.

Së katërti, “kemi dyshime se ambienti i propozuar si vend për kryerjen e shërbimit, nuk përmbush kriteret minimale të sigurisë si edhe nuk është i vëzhguar 24 h me system operativ kontrolli, kamera në përputhje me kriteret e vecanta të kualifikimit. Kemi dyshime të arsyeshme se nga ana e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k janë dorëzuar fotografi (të cilat sigurisht nuk mund të vërtetohen se së pari është ambient i tij në përdorim dhe së dyti nuk përmbushet qëllimi i autoritetit kontraktor se ambienti i propozuar përmbush minimumin e kërkesës për sigurinë.”

Lidhur me pretendimin tuaj se ambienti i paraqitur nëpërmjet fotove nuk vërteton faktin nëse ambienti i përket shoqërisë “Adel Co” sh.p.k [...] K.SH.A vëren se në kriteret e kualifikimit është kërkuar shprehimisht që disponimi i ambientit nga ana e operatorit ekonomik duhet të vërtetohet nëpërmjet fotove, fakt të cilin operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k e ka përmbushur në përputhje me kriteret e vecanta të kualifikimit të DST. [...] KVO nuk mund të skualifikojë një operator ekonomik përderisa në

kriteret e vecanta të kualifikimit është përcaktuar qartë që vërtetimi i ambientit do të kryhet nëpërmjet fotove të paraqitura në SPE si dhe nuk mund të përdorë një kriter si arsye skualifikimi i cili nuk është përfshirë në kriteret e vecanta të kualifikimit. Në të kundërt përdorimi i një kriteri i cili nuk është parashikuar në kriteret e vecanta të kualifikimit do të cënonte qëllimet dhe parimet e përzgjedhjes të parashikuara në legjislacionin e prokurimeve publike.

Së pesti në ankesën e paraqitur pranë UKT sh.a ankimuesi pretendon se “shoqëria “Adel Co” sh.p.k nuk disponon makineri printimi dixhitale me ngjyra me kapacitet minimal printimi prej 50.000 faqe në ditë. Në dijeninë tonë shoqëria “Adel Co” sh.p.k disponon marrëveshje partneriteti dhe pjesë të printerave dixhitale, printera të markës RICOH. Bazuar në dyshime të arsyeshme, duke marrë në konsideratë edhe llojin e pajisjeve (printera industrial) printer i vetëm me ngjyra i prodhuesit RICOH është seria e printerave PRO C901 dhe 901/s. Kapaciteti maksimal (në rast se janë tërësisht të konfiguruar) në ditë është 13.500 fletë ndërkohë që, referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit është 50.000 fletë. Gjithashtu printer tjetër me ngjyra për përdorim industrial është kategoria e printerave RICOH 907EX/1107EX/135EX. Edhe në hipotezën se kjo shoqëri disponon në pronësi printera të modelit të sipërpërmendur, sërish nuk përmbush kapacitetin teknik, pasi rezulton se kapaciteti maksimal (në rast se janë të konfiguruar) në ditë është 10.500 fletë, ndërkohë që referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit është 50.000 fletë. ... Kemi sërish dyshime se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k nuk e disponon kartelën (skedën teknike) të makinerive origjinale nga prodhuesi [...].”

K.S.H.A duke iu referuar pretendimit tuaj se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k nuk disponon makineritë me kapacitet 50.000 fletë gjykon se pretendimet e parashtruara nga ana juaj nuk qëndrojnë.

II.6. Në datën 07.02.2019 operatori ekonomik “Albanian Digital Printig Solutions & Services” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 20.02.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 190/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. K-570/1 prot., datë 18.02.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 190/3 prot., datë 05.03.2019 Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nëse shoqëria “Adel Co” sh.p.k, në datën 09.01.2019, rezulton apo jo me detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore, tatim mbi fitimin dhe TVSH. Nëse operatori ekonomik rezulton me detyrime ndaj administratës tatimore, kërkojmë informacion konkret për detyrimin tatimor.

II.9. Në datën 18.03.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 190/5 prot., shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me nr. 11622/1 prot., datë 13.03.2019, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 190/3 prot., datë 05.03.2019, protokolluar me tonën nr. 11622 prot., datë 08.03.2019, ku keni kërkuar informacion për detyrimet tatimore të subjektit Adel Co në datën 09.01.2019, nga konfirmimi i ardhur nga Drejtoria e IT, subjekti i mësipërm rezulton me detyrime si

vijon: Këste paraprake Tatim Fitimi për vitin 2018 me vlerën 1.137.996 lekë, Detyrime në Tatimin e Mbajtur në Burim me vlerë 23.490 lekë, Kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore me vlerë 245.716 lekë.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albanian Digital Printig Solutions & Services” sh.p.k se shoqëria “Adel CO” sh.p.k duhet skualifikuar pasi: *“ka dorëzuar deklarime të rreme për qëllime kualifikimi si edhe mbi të gjitha, duke patur detyrime tatimore pranë Administratës Tatimore në vlerën 1.900.000 lekë, në ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit datë 09.01.2019”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, është përcaktuar shprehimisht se:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Adel Co" sh.p.k., konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

Shtojca "Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme", ku deklarohet se "Operatori ekonomik "Adel Co" sh.p.k. ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi".

III.1.3. Në nenin 45 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur:

a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

ç);

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) Vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të njëvlefshëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në 1 dhe 2, shkronja “a”, “b” dhe “c”.

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.6. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k është paraqitur Shtojca 7 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, me datë 09.01.2019, nëpërmjet të cilës kjo shoqëri deklaron se ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Pas kërkesës për informacion të drejtuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, Drejtorisë Rajonale Tatimore si organi kompetent dhe përgjegjës për menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me detyrimet tatimore të shoqërive të ndryshme, kjo e fundit, në përgjigjen e sjellë, sqaron se: “Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 190/3 prot., datë 05.03.2019, protokolluar me tonën nr. 11622 prot., datë 08.03.2019, ku keni kërkuar informacion për detyrimet tatimore të subjektit Adel Co në datën 09.01.2019, nga konfirmimi i ardhur nga Drejtoria e IT, subjekti i mësipërm rezulton me detyrime si vijon: Këste paraprake Tatimi Fitimi për vitin 2018 me vlerën 1.137.996 lekë, Detyrime në Tatimin e Mbajtur në Burim me vlerë 23.490 lekë, Kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore me vlerë 245.716 lekë.”

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.9. Sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k , referuar dokumentacionit të sjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore, në datën 09.01.2019, (që është edhe data e hapjes së ofertave), rezulton me detyrime: *Këste paraprake Tatim Fitimi për vitin 2018 me vlerë 1.137.996 lekë, Detyrime në Tatimin e Mbajtur në Burim me vlerë 23.490 lekë, Kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore me vlerë 245.716 lekë*, ndaj dhe duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e mësipërme të prokurimit, pasi ka cështje të përmendura në pikën 2 gërma “d” e “dh” të nenit 45 si më sipër cituar.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i pavlefshëm e, rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Albanian Digital Printig Solutions & Services” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albanian Digital Printig Solutions & Services” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-90314-10-17-2018 me objekt: “*Shërbim printimi fatura uji*”, me fond limit 19.190.164,50 lek pa tvsh, zhvilluar ne daten 09.01.2019 nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co ” sh.p.k, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albanian Digital Printig Solutions & Services” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 190 Protokolli,

Datë 07.02.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha